



MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO

NJOFTIMI I PËRGJITHSHËM I PROKURIMIT (NJPP)

Qeveria e Republikës së Kosovës

Fondacioni i Mijëvjeçarit i Kosovës (MFK)

Qeveria e Kosovës ka pranuar financimin në formë të grantit në shumën prej 49 milionë \$ (dyzet e nëntë milionë dollar amerikan) nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC) e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me synimin që të i mundësojnë Qeverisë së Republikës së Kosovës zbatimin e këtij programi dhe arritjen objektivave të përcaktuara në Marrëveshjen e Pragut për Grantin e MCC, si dhe synon të shfrytëzoj një pjesë të fondeve për pagesën e kontratave për mallra, punime dhe shërbime.

Financimi për MCC-së është ndarë nga Kongresi i SHBA-ve dhe i zotohet projektit (kompaktit) paraprakisht, pa ndonjë financim shtese apo të pjesshëm. Kur nënshkruhet kontrata me shtetin përfitues, fondet tashmë janë në dispozicion dhe, në shumicën e kontratave, faturat u paguhen kontraktorëve/konsulentëve/furnizuesve drejtpërdrejt nga Thesari i SHBA-ve.

Programi i prokurimit për këtë periudhë do të përfshijë si në vijim:

Aktivitetet e prokurimit për periudhën Nëntor 2020 – Dhjetor 2020
<i>Prokurimi i mallrave</i> <i>Në projektin “Peizazhi i Energjisë së Qëndrueshme” duke përfshirë:</i>
DHM - Furnizimi dhe instalimi i sistemit të njehsorëve për ngrohjen qendrore
<i>Prokurimi i punimeve</i> <i>Në projektin “Peizazhi i Energjisë së Qëndrueshme” duke përfshirë:</i>
Pakon intervenuese për Rinovimet për Efiçencë në Njësitë e Banimit (HER) - Materialet dhe produktet për EE
AER - Punimet e nënaktivitetit “Rinovimet për Efiçencë në Ndërtesa Shumëbanesore”

<p><i>Prokurimi i shërbimeve</i></p> <p><i>Në projektin Peizazhi i Energjisë së Qëndrueshme, në Projektin e Qeverisjes Transparente dhe në sektorin e administratës, duke përfshirë:</i></p>
<p>Softueri, hardueri dhe AT për Programin "Qasja e Publikut në Informata Gjyqësore" (Sistemi për Menaxhimin e Informatave të Rastit "SMIR") në aktivitetet e komunikimit dhe kontaktimit</p>
<p>Konsulenca (Punëtorja e palëve të interesit për Sfidën "Dig Data" për Gjyqësorin)</p>
<p>Prokurimi i Shërbimeve të Konsulentit për PPE dhe Konsulentit për Përshpejtuesin e Projektit për Eficiencën e Energjisë dhe për Zhvillimin e Gazsjellësit: Trajnimi nga ana e kërkesës, angazhimi në nivelin e firmës dhe strategjia e marketingut</p>
<p>Aktivitetet e komunikimit dhe kontaktimit për Sfidën e të Dhënave Gjyqësore (Judicial Data Challenge)</p>
<p>Menaxhimi i evenimenteve për punëtoritë dhe aktivitetet promovuese të SMIR</p>
<p>Konsulentët - Juria për Sfidën e të Dhënave të Hapura (Open Data Challenge)</p>
<p>Ceremonia e ndarjes së çmimeve "Dig Data për cilësinë e ajrit" si dhe promovimi dhe eventet për "Dig Data" mbi energjinë</p>
<p>Konsulent për të ndihmuar në aktivitetet e Programit të Praktikës dhe Bursave të projektit Gratë në energji (GE-së)</p>
<p>Ndërlidhja dhe menaxhimi me institucionet e mundshme pritëse në sektorin e energjisë me aktivitetet e Programit të Praktikës dhe Bursave të GE-së.</p>
<p>Aktivitetet e kontaktimit dhe eventet i lansimit për Programin e Praktikës</p>
<p>Rishikimi i cilësisë së të dhënave për Projektin e Peizazhit të Energjisë së Qëndrueshme dhe Projektin e Qeverisjes Transparente</p>
<p>Konsulencë (Trajnimi i të dhënave të hapura për qeverinë/OSH-të/sectorin privat) për Dig Data të Energjisë</p>

Kontratat për mallra, punime dhe shërbime të financuara nga programi do të zbatohen sipas parimeve, rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Udhëzuesin e Prokurimit të Programit MCC, të cilat mund të gjenden në ueb faqen e MFK-së.

Prokurimi është i hapur për të gjithë ofertuesit nga vendet e kualifikueshme burimore, siç përcaktohet në Udhëzuesin e Prokurimit të Programit MCC.

Njoftimet specifike të prokurimit për kontratat që do të tenderohen sipas procedurave të ofertimit konkurrues dhe për kontratat e konsulentëve do të shpallen, sapo të vihen në dispozicion, në ueb faqen e MFK-së: <https://millenniumkosovo.org/>, Biznesi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDB): <http://www.devbusiness.com/>, Development Gateway Market (dgMarket): <http://www.dgmarket.com/>, në gazetatat vendore, dhe media të tjera, sipas nevojës.

Kontraktuesit dhe konsulentët e kualifikueshëm dhe të interesuar që dëshirojnë të përfshihen në listën e postës (distribuimit) për të marrë njoftimin automatikisht për shpalljet duhet të abonohen në ueb faqen e MFK-së tek linku: <https://millenniumkosovo.org/subscribe/>, shkruani e-mailin tuaj dhe përzgjidhni tek lista Prokurimi, ose ata që kërkojnë informacion shtesë, duhet të kontaktojnë:

Menaxheri i Prokurimit:	Arton Çitaku – Menaxher i Prokurimit i MFK-së
c/o:	Fondacioni i Mijëvjeçarit i Kosovës
Adresa:	Rr. “Migjeni”, nr. 21 (ish-Banka e Lubjanës, kati IX), Kodi postar:10000 Prishtinë, Kosovë
Telefoni:	+ 383 38 752 110
Email:	procurement@millenniumkosovo.org